

# AKT THEMELIMI I SHOQERISE "REAM 95"



## NENI 1

Formohet shoqëria me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin "REAM" sh.p.k. me ortak të vetëm Ilir Naipi, i biri i Sados d.t.l. 1949, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, Rr.Budi P.61/1 Ap.1.

## NENI 2

Selia e shoqërisë është në Tiranë, rruga "Budi" Pl.61/1 Ap.5.

## NENI 3

Kohë zgjatja e shoqërisë është mbi 10 vjet.

## NENI 4

Objekti i veprimtarise ekonomike te shoqerise eshte në fushën e projekti-mit dhe zbatimit, ndertimeve civile, industriale, turistike, bujqesore etj. dhe kompletimi me instalimet e nevojshme per to, punime restaurimi, tregtim me shumice e pakice, brenda dhe jashte vendit ne te gjitha llojet e mallrave ushqimore, industriale, elektroshtepiake, prodhime dhe tregetim te materialeve te ndertimit, blerje dhe shitje te mjeteve te ndryshme, transportim mallrash, grumbullim dhe shitje me shumice dhe pakice te produkteve bujqesore, blegtorale, bimore eterovajore etj.

## NENI 5

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 leke qe i perket ne menyre te plote ortakut te vetem Ilir Naipi.

## NENI 6

Shoqeria "REAM 95" sh.p.k. administrohet dhe drejtohet nga nje administrator i vetem qe me ane te ketij akti emerohet Ilir Naipi.

## NENI 7

Struktura, organet dhe modalitetet e tjera pasqyrohen ne statut, qe se bashku me kete akt perbejne nje teresi te vetme e te pandare dhe qe miratohet nga ortaku i vetem.

## NENI 8

Fitimi i realizuar i perket teresisht ortakut te vetem e administra-torit sipas dispozitave te statutit.

Viti i pare ushtrimor mbyllt me 31 Dhjetor 1995.

**NENI 9**

Per çdo gje tjeter qe nuk gjen pasqyrim ne kete akt e as ne statut, zbatohen dispozitat, vendimet dhe ligjet ne fuqi.

**NENI 10**

Akti themelues perpilohet ne 3 (tre) kopje origjinale, te barazvlefeshme duke mbetur nje kopje si pjese e dokumentacionit te formimit te shoqerise.

Tirane, me 7/9/ 1995

ADMINISTRATOR

ORTAKU I VETEM -

( Ilir Naipi )